



**Organization for Security and Co-operation in Europe
Presence in Albania**

**Holandezi Robert Bosch emërohet Kryetari i ri i Prezencës së
OSBE-së në Shqipëri**

VJENË, 16 tetor 2007 – Robert Bosch nga Mbretëria e Holandës u emërua Kryetari i ri i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Ai do ta marrë këtë detyrë më 25 tetor.

Emërimi në këtë post vjen pas shërbimit të tij për dy vjet si zëvendëspërfaqësues i përhershëm i delegacionit holandez në OSBE. Para kësaj, Bosch mbajti disa poste në ambasadat e Mbretërisë së Holandës në Portugali, Luksemburg dhe Vjenë. Ai shërbeu, gjithashtu, si përfaqësues i posaçëm i Holandës në Konferencën Botërore të Kombeve të Bashkuara për Uljen e Varfërisë, si dhe këshilltar i posaçëm për Kryesinë holandeze të Bashkimit Evropian.

Bosch pason në këtë detyrë Pavel Vacek nga Republika Çeke, i cili shërbeu si Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për periudhën 2004-2007. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri u krijua nga Këshilli i Përhershëm i OSBE-së më 27 mars 1997.